

4 FORMA ALTERNATIVE NË VEND TË ARRESTIMIT TË KUNDËRVAJTËSVE TË MITUR, MANUALI I PRAKTIKAVE TË MIRA NË EVROPË

Materiali më poshtë përmbledh gjetjet kryesore mbi alternativat e arrestimit të të miturve kundërvajtës dhe përfitimet kryesore të palëve të përfshira në këto procedura. Kategorizimi i përdorur nuk është shterues dhe mund të përdoren dhe lloje të tjera, megjithatë këto masa përfshijnë disa nga shembujt më të zakonshëm.

- **Shërbimi i Provës, shërbimi në komunitet dhe vendosja e gjobave**

Gjorbija është një alternativë e mundshme sipas ligjit në shumë juridiksione në fazën e dënimit. Kundërvajtësit e mitur mund të detyrohen të kompensojnë ose t'i paguajnë një pjesë të dëmit viktimës. Shpesh, ky është një element që gjendet tek shumë procese të drejtësisë restauruese. Kur cakton gjorbën si masë alternative, gjyqtari i çështjes duhet të ketë parasysh edhe mundësinë që ka i riu/ e reja për ta paguar.

Shërbimi i provës është një nga llojet më të zakonshme të dënimeve alternative, ku i riu vendoset nën mbikëqyrjen e oficerit të shërbimit të provës në komunitet. Persona duhet të plotësojë disa kërkesa specifike si kufizim oraresh dhe mënyrën e sjelljes. Krahas kësaj, mund të kërkohej që të marrë pjesë në programe edukative ose trajnime, të cilët konsiderohen si të dobishme. Shërbimi i provës mund të shërbejë edhe si portë hyrëse për të rinjtë drejt këshillimit apo shërbimeve udhëzuese. Shpesh, departamente të ndara të shërbimit të provës janë të dedikuara specifiku për supervizimin e të rinjve nën 18 vjeç. Shërbimi i provës ose supervizimit zgjat për një periudhë të caktuar kohore.

Përfitimet:

- Mund të ndihmojnë të garantosh një nivel përgjegjshmërie tek i riu, megjithëse kërkohen disa element të shërbimit në komunitet.
- I jep mundësinë të rinjve të riparojnë një pjesë të dëmit që I kanë shkaktuar komunitetit nga vepra e tij/saj.
- Nëse kjo detyrë përfshin edhe përfitimin e viktimës së veprës, mund të thuhet se ka elementin restaurues
- Zbatohen Brenda komunitetit ku jeton kundërvajtësi duke i dhënë kështu mundësi të riut për rehabilitim dhe ri-integrim.

- **Masat edukative dhe këshillimi**

Urdhrat e këshillimit parashikojnë që i riu të bëhet çift me një vullnetar të rritur nga komuniteti. Këshilltarët mund të punojnë me të riun dhe familjen dhe të takohen rregullisht. Ata ofrojnë mbështetje, këshillim dhe udhëzim për të rinjtë dhe dëgjojnë të riun dhe shqetësimet që mund të kenë.

Ndërhyrjet edukative: rregullat evropiane për të rinjtë që i nënshtrohen sanksioneve ose masave duhet të mbështeten tek parimet e integritit social, edukimit dhe parandalimit të ri-kryerjes së krimit. Kur merren parasysh sanksionet në komunitet i duhet dhënë prioritet atyre që mund të kenë një efekt edukativ si dhe të jenë një masë restauruese. Urdhrat mund të kërkojnë që të rinjtë të marrin pjesë në trajnime ose programe specifik mësimore ose profesionale ose të marrin pjesë tek grupet rinore. Masat edukative mund të ofrohen tek qendrat ditore ose t'i japin mundësinë të riut/resë të qëndrojnë në familje, megjithatë në disa juridiksione është e mundur që vendoset që fëmija do të qëndrojë në një ambient rezidencial ose shtëpi edukuese për një periudhë të caktuar kohe.

Përfitimet:

- Mund të jepet ose gjatë kohës që personi qëndron në komunitet ose në shtëpi edukative, për kujdes birësues;
- Shpesh punohet ngushtë me familjen e të riut si dhe vetë me personin
- Shërbime mbështetëse për kujdesëse nëse personi është në një mjedis jashtë familjes për t'i asistuar që të kthehen më pas tek familja dhe komuniteti
- Jep mundësinë për ndërhyrje specifike që synojnë një problem sjellje të caktuar që mundësojnë zhvillimin social dhe psikologjik të të riut
- E rekomanduar edhe nga udhëzimet ndërkombëtare, sidomos Rregullat Evropiane për të miturit që janë subjekt sanksionesh ose masash alternative

- **Masa të kujdesit ose terapeutike**

Masat alternative që mbështeten tek ofrimi i kujdesit dhe tek nevojat e fëmijës për mirëqenie përdoren në disa juridiksione. Një nga masat e zakonshme në këtë kategori përfshin edhe kujdesin birësues (foster). Këto urdhra mund të jenë veçanërisht të dobishëm nëse mendohet se mjedisi familjar po ndikon te sjellja kundërvajtëse. Urdhrat mund të parashikojnë bashkëjetesë me një person tjetër, familje ose grup edukativ. Synimi është të ofrohet kujdes për të riun jashtë ambientit familjar për një periudhë kohe, gjatë së cilës mund të punohet me sjelljen kundërvajtëse. Këto masa mund të kombinohen ose me masat edukative ose terapeutike.

Masat me synim ose komponent terapeutik përdoren në disa juridiksione. Sidomos aksesi tek shërbimet këshillimore, përdoret shpesh si komponent përbërës i një mase tjetër (për shembull, një kundërvajtëse që është në shërbim prove mund t'i jepet akses tek këshillimi në këtë mënyrë), ose është si masë e ndarë. Pjesëmarrja tek programet e menaxhimit të inatit ose varësisë përdoret gjithashtu si masë alternative, ku këto konsiderohen të përshtatshme për një person të ri. Ndërhyrjet që përfshin terapinë multi-sistematike (MST) janë gjithashtu duke u bërë ndërhyrje të zakonshme terapeutike si masë alternative.

Përfitimet:



- Të lejon përfshirjen e këtyre masave në kuadre të ndryshme ligjore dhe kontekste të ndryshme ligjore dhe sociale;
- Të jep mundësinë për të kryer ndërhyrje me bazë kujdesi qoftë kur i riu qëndron në ambientin familjar ose kur bashkëjeton me një person tjetër, familje ose grup;
- Shumë e dobishme nëse mendohet se ambienti familjar po kontribuon tek sjellja kundërvajtëse;
- Mund të përdoret për të synuar një problem në sjellje ose grupe të veçanta të rinjsh që kanë probleme, përfshirë edhe ata që mendohen se janë në rrezik të lartë
- Mund të përdoret për të rinjtë që nuk mund të përfitojnë ndryshe nga përdorimi i masave alternative
- Synimi i programeve specifike për lloje të ndryshme të sjelljeve problematike mundëson adresimin e drejtpërdrejtë të sjelljes kriminale
- Ofron një mekanizëm për teknikat psikologjike si terapia e sjelljes konjitive e cila përfshihen në ndërhyrje
- Tregues të efekteve pozitive tek të rinjtë

- **Qasjet restauruese**

Drejtësia restauruese (DR) është kthyer në aspektin kryesor të shumë praktikave të sistemeve të drejtësisë restauruese. DR synon të riparojë dëmin që ka shkaktuar sjellja kriminale duke bashkuar kundërvajtësin, viktimën dhe anëtarët e komunitetit. Përdoret gjerësisht tek sistemet e drejtësisë për të mitur dhe shpesh merr formën e takimeve me grupet familjare. Tek kjo lloj drejtësie restauruese, fëmija, prindërit e tij/saj ose kujdestarët apo një i rritur tjetër i përshtatshëm, takohen me viktimën dhe me anëtarë të tjerë të komunitetit, madje edhe mësuesit dhe fëmija mund të përfshihen nëse mendohet se është e dobishme. Procesi i jep shumë hapësirë viktimës që të tregojë sesi ka ndikuar vepra tek ai/ajo. Shpresohet që kundërvajtësi do të kuptojë sesa dëm kanë shkaktuar veprimet e tij/saj dhe do të ndjejë përgjegjësi për këto veprime. I riu do t'i kërkojë falje viktimës dhe do ta riparojë në një lloj mënyre ose do t'i paguaj kompensim viktimës.

Përfitimet:

- I jep mundësinë përfundimtare të riut të shmang paraburgimin
- I ofron gjyqtarit një alternativë të rëndësishme dhe një mënyrë për të mos burgosur të riun, kur kjo është e mundur
- Qasje të ndryshme janë të mundshme për të adresuar këtë problem të përbashkët
- Ofrojnë një mundësi të vlefshme të riut për të shmangur paraburgimin, kur në raste të tjera do të ishte e pashmangshme.

Përgatitur nga Simona Demková për Platformën për Mbrojtjen e Fëmijëve për Evropën Juglindore, qershor 2016

Burimi: International Juvenile Justice Observatory, *Alternatives to Detention For Juvenile Offenders: Manual of Good Practices in Europe*. Bruksel: International Juvenile Justice Observatory, 2016. Web.